



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË FUSHË KOSOVËS PËR VITIN 2019

Prishtinë, Korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Fushë Kosovës, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Albesa Tolaj-Ramosaj* dhe anëtarët *Abdurrahmon Berbatovci* dhe *Mexhit Ferati*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Shkëlqim Xhema*.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	21
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	27
Shtojca II: Letër e Konfirmimit.....	29

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i komunës së Fushë Kosovës për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Procesi i përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore është menaxhuar në pajtim me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të keq klasifikimit të shpenzimeve të cilat kanë ndikuar në theksimin e çështjes.

Edhe pse kontrollet e brendshme kanë operuar në mënyrë efektive në disa fusha, menaxhimi financiar dhe kontrolli është përcjellë me dobësi evidente në disa sisteme të rëndësishme financiare. Kontrollet kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar dobësitë lidhur me: menaxhimin e të hyrave, personelin, menaxhimin e subvencioneve, menaxhimin e kontratave të investimet kapitale, sfidat në menaxhimi i të arkëtueshmeve, vonesave në pagesa si dhe funksionimin jo efikas të njësisë së auditimit të brendshëm dhe komitetit të auditimit.

Përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak, tregon që komuna prej 14 rekomandimeve, shtatë (7) rekomandime kishte zbatuar, pesë (5) rekomandime nuk ishin zbatuar ende dhe dy (2) rekomandime janë konsideruar të mbyllur.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së Fushë Kosovës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve së Komunës së Fushë Kosovës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Theksimi i çështjes

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se përmes planifikimit buxhetor Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në kategori ekonomike jo adekuate. Nga kategoria e investimeve kapitale si dhe subvencioneve dhe transfereve kishte paguar për mallra e shërbime, ndërsa thesari prej mallrave dhe shërbimeve kishte paguar pagat jubilarë të punëtorëve të arsimit përmes vendimeve gjyqësore. Në këtë raporte kjo çështje është trajtuar tek nënkapitulli 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna në përgjithësi ka të vendosur sistem të mirë të kontrolleve në raport me obligimet statutores të saj. Megjithatë, fusha kryesore ku nevojitet më shumë përmirësime është parandalimi i keq klasifikimit të shpenzimeve. Gjithashtu, rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet kontrolleve në këto fusha: menaxhimin e të hyrave, mos përfshirje në lista të pagave, menaxhimin e subvencioneve, mos vazhdimin e sigurisë së ekzekutimit, mangësi në menaxhimin e kontratave, ndarje jo e duhur e detyrave, sfida në menaxhimi i të arkëtueshmeve, vonesave në pagesa si dhe funksionimin e njësisë së auditimit të brendshëm dhe komitetit të auditimit.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	11,097,733	14,236,233	11,645,281	82%	9,767,699	8,544,687
Granti i Qeverisë – Buxheti	8,574,155	8,574,155	8,241,745	96%	7,279,679	6,491,101
Të bartura nga viti paraprak ³ –	-	2,525,862	1,891,886	75%	1,229,372	904,444
Të hyrat vetjake ⁴	2,439,993	2,989,993	1,444,994	48%	1,210,449	1,072,629
Donacionet e brendshme	-	125,492	53,039	42%	35,313	63,534
Donacionet e jashtme	-	14,185	8,789	62%	10,022	12,979
Financimi nga Huamarrja	83,585	6,546	4,827	74%	2,864	-

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të komunave të pasqepënuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 3,138,500€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 2,525,862€, të hyrave vetanake prej 550,000€, nga donacionet e brendshme dhe të jashtme për 139,677€ ndërsa kishte zvogëlim të buxhetit për 77,039€ nga financimi nga huamarrja.

Në vitin 2019, komuna ka shpenzuar 82% të buxhetit final ose 11,645,281€, me një përmirësim për 2.5% krahasuar me vitin 2018. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	11,097,733	14,236,233	11,645,281	82%	9,767,699	8,544,687
Pagat dhe Mëditjet	4,848,709	4,900,709	4,775,829	97%	4,585,983	4,433,952
Mallrat dhe Shërbimet	1,301,707	1,433,329	1,374,137	96%	766,733	662,379
Shërbimet komunale	200,000	317,327	274,657	87%	150,000	149,925
Subvencionet dhe Transferet	294,657	760,153	623,395	82%	308,850	362,657
Investimet Kapitale	4,452,660	6,824,715	4,597,263	67%	3,956,133	2,935,774

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Rritja e buxhetit final për 52,000€, krahasuar me buxhetin fillestar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar për drejtorinë e arsimit, për të mbuluar shpenzimet e pagave të arsimtareve të punësuar si rezultat i shtimit të numrit të banorëve në Fushë Kosovë;
- Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar për mallra dhe shërbime ishte rritur për 131,622€. Fillimisht ishte zvogëluar për 78,873€ nga financimi për huamarrje si rezultat i mos alokimit të mjeteve në drejtorinë e shëndetësisë, pastaj ishte rritur prej të hyrave vetanake 50,000€, të hyrave të bartura 160,461€ si dhe financimit nga donacionet e jashtme prej 34€;
- Rritja e buxhetit final për shërbimet komunale ishte 117,327€. Kjo rritje ishte si rezultat i të hyrave vetanake të bartura nga komuna në vlerë 67,327€, dhe të hyrave vetanake të realizuara gjatë vitit në vlerë prej 50,000€. Rritja ishte bërë me qëllim të shlyerjes së borxheve të mëhershme të komunës;

- Buxheti final krahasuar me atë fillestar për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve kishte pësuar rritje prej 465,496€. Rritja ishte si rezultat i të hyrave vetanake në vlerë 240,000€, të hyrave të bartura prej 100,004€ si dhe donacioneve të brendshme përmes participimit të qytetarëve në vlerë prej 125,492€; dhe
- Buxheti final për shpenzime kapitale ishte rritur për 2,372,055€, nga të hyrat vetanake në vlerë prej 158,000€, të hyrave të bartura 2,198,070€, financimit përmes huamarrjes në vlerë 1,834€ si dhe donacioneve të jashtme prej 14,151€.

Lidhur me klasifikimin e shpenzimeve ne kemi trajtuar çështjen si në vijim:

Çështja B1 - Keq klasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet të aplikojnë.

Siç kemi paraqitur të theksimi i çështjes, komuna ka paguar shpenzime në vlerë 305,708€ nga kategoria joadekuate e shpenzimeve. Prej tyre 245,734€ ishin bërë nga kategoria e investimeve kapitale për mallra dhe shërbime, e të cilat kishin qenë të planifikuara dhe buxhetuara gabimisht, ndërsa 59,974€ ishin bërë nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve që i takonin kategorisë së mallrave dhe shërbimeve e të cilat nuk kanë qenë të planifikuara me buxhet, por janë kryer dhe regjistruar gabimisht nga komuna. E gjithë kjo ka qenë si pasojë e buxhetit të kufizuar për mallra dhe shërbime e të cilat janë të domosdoshme, andaj edhe si të tilla ishin aprovuar me ligjin e buxhetit.

Më tutje, përmes vendimeve gjyqësore (përmbaruesve private), janë paguar nga gjithsej 83,203€. Prej tyre, 45,926€ ishin nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ndërsa 37,277€ ishin nga investimet kapitale, shpenzime këto që i takonin kategorisë së pagave dhe mëditje për paga jubilarë të mësimdhënësve.

Për këto, komuna kishte bërë përpjekje gjatë vitit 2019 që të alokonte mjete shtesë në kategorinë e pagave dhe mëditjeve në mënyrë që të evitonte çështjet e tilla ndërsa në PFV e vitit 2018 kishte prezantuar apo shpalosur si detyrime kontigjente.

Ndikimi Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, ndikojnë në keq klasifikimin e shpenzimeve në Pasqyrat Financiare të Komunës dhe si të tilla japin informata jo të sakta për shfrytëzuesit e PFV-ve.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo ridestinin të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2019 ishin në vlerë 2,621,769€. Ato kanë të bëjnë me: të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, të hyrat nga qiraja, taksat administrative, etj. Gjithashtu, komuna kishte edhe të hyra indirekte të mbledhura nga dënimet në trafik në vlerë 738,774€.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e pranimeve 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat tatimore	650,000	778,320	778,320	100%	648,521	599,368
Të hyrat jo tatimore	1,789,993	1,843,449	1,843,449	100%	1,752,828	1,423,289
Totali	2,439,993	2,621,769	2,621,769	100%	2,401,349	2,022,657

Të hyrat e arkëtuara nga komuna për vitin 2019 janë realizuar për 181,776€ apo 7% më shumë se të hyrat e planifikuara me buxhetin fillestar. Ndërsa të hyrat e arkëtuara në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 janë rritur për 220,420 apo 9%. Lidhur me testet tona, ne kemi trajtuar si në vijim:

Çështja A1 - Mos verifikimi i pronave tatimore

Gjetja Sipas nenit 15 të Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.

Në vitin 2019, prej 14,364 pronave të regjistruara kishte arritur të kryej verifikimin e vetëm 2,128 apo 15% të pronave të paluajtshme.

Sipas zyrtarëve komunal mos verifikimi i pronës ka ndodhur si rezultat i mos funksionimit të pajisjeve elektronike në përkrahjen e sistemit të tatimit në pronë dhe nevojës për pajisje me teknologji të re për verifikim të pronave.

Ndikimi Mos verifikimi i 20% të pronave ndikon negativisht në vlerësimin dhe faturimin real të tatimit në pronë dhe mund të rezultojë edhe me nënvlerësimin e të hyrave nga kjo kategori.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave komunale do të bëhet ashtu siç parashihet me ligj duke bërë verifikimin e pronave së paku 20 % në vit, për të reflektuar në gjendjen reale të pronave të tatuara.

Çështja A2 Vonesa në shqyrtimin e ankesave të tatimpaguesve

Gjetja Sipas Ligjit Nr 06/L-055 për Tatimin në pronën e paluajtshme, neni 31, pika 6 të përcakton që "Komuna merr vendim në lidhje me ankesën e dorëzuar brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga pranimi i ankesës. Komuna i dërgon personit vendimin brenda pesë (5) ditëve pune pas datës së marrjes së vendimit

Në dy nga tre raste të testuara për ankesat e bëra nga tatimpaguesit lidhur me pasaktësinë e faturës së tatimit në pronë, shqyrtimi i tyre ka tejkaluar afatin ligjor të shqyrtimit nga 17 përkatësisht 30 ditë vonesë. Po ashtu nuk kishte njoftuar tatimpaguesit brenda afatit ligjor prej 5 ditëve pas marrjes së vendimit.

Sipas zyrtarëve përgjegjës vonesat ishin si rezultat i volumit të madh të punëve si dhe mungesës së stafit në këtë drejtori të komunës, përkundër faktit që kemi rritje të popullsisë dhe ndërtimeve të reja në komunë.

Ndikimi Vonesat në shqyrtimin e ankesave nga komuna si dhe mungesa e stafit në drejtorin përkatës ndikon në vonesat apo mos kryerjen e pagesave nga tatimpaguesit e që do të rezultonte në rritjen e arkëtueshmeve për tatimin në pronë.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të inicioj aprovimin e pozitive të reja në drejtorit që kanë mungesë të stafit dhe të siguroj që shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve si dhe njoftimi i tyre bëhet brenda afateve ligjore.

Çështja B2 - Mos arkëtimi i të hyrave sipas kontratave

Gjetja Sipas Ligjit 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 7, përcakton që prona e paluajtshme e komunës mund të jepet në shfrytëzim për të gjithë personat fizik dhe juridik me një afat të caktuar. Ndërsa bazuar në kushtet e kontratave të shfrytëzuesve të pronës, pagesa e obligimit duhet të bëhet deri në fund të javës së parë të secilit muaj vijues.

Lidhur me këtë, nga testimi i tri kontratave për shfrytëzimin e pronës publike, identifikuam se në dy raste për shkak të mos pagesës mujore nga qiramarrësit, komuna nuk kishte arritur të arkëtojë të hyrat për vitin 2019 në vlerë prej 2,823€ duke e rritur në vlerë totale vlerën e të arkëtueshmeve në 16,532€. Përkundër rekomandimit nga viti i kaluar, komuna ende nuk kishte ndërmarrë veprime për arkëtimin e të hyrave në fjalë.

Ndikimi Vazhdimi i praktikave të tilla të menaxhimit jo të mirë të kontratave të qirasë mund të nxisin obliguesit tjerë që t'i shmangen pagesës së qirave, si dhe të rrit vlerën e të arkëtueshmeve.

Rekomandimi B2 Kryetari, duhet të sigurojë se asnjë pronë publike nuk do të lejohet të shfrytëzohet pa pagesën e qirave të parapara me kontratë. Duhet të gjenden forma, që të merren masa të menjëhershme (një mundësi e tillë përmes përmbaruesit) që detyrojnë obliguesit të respektojnë detyrimet kontraktuale.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për 2019 është 4,900,709€, ndërsa shpenzimi ishte 4,775,829€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 772 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 757€. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 14 të rinj. Kemi testuar 36 mostra për teste substanciale në vlerë 16,672€, si dhe 13 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A3 - Mos përfshirja e të punësuarit në listat e pagave

Gjetja Ligji i Buxhetit Nr.06/L-133 neni 12 pika 2 specifikon se me kusht që numri total i lejuar i të punësuarve dhe shuma e lejuar e buxhetit në kuadër të organizatës nuk ndryshon, numri i të punësuarve dhe ndarjet buxhetore nëpër nën-programe në tabelat 3.1, 3.1A dhe 4.1 mund të përshtaten me vendim të Ministrit me arsyetim përkatës nga Komuna. Në rastin e organizatave buxhetore të nivelit lokal nevojitet paraprakisht edhe vendimi i Kuvendit Komunal për ndryshime në fjalë.

Në një rast komuna kishte zhvilluar procedurat e rekrutimit për pozitën “Zyrtar ligjor” në Drejtorinë e Arsimit dhe kishte nënshkruar kontratën me zyrtarin me datën 29.11.2019, pavarësisht se në këtë drejtori nuk kishte buxhet për këtë pozitë. Si rezultat i kësaj ky zyrtar nuk ishte futur në listën e pagave deri në muajin prill të vitit 2020. Po ashtu, nuk ishte kompensuar në mënyrë retroaktive për periudhën për të cilën nuk ishte përfshirë në listë të pagave.

Kjo kishte ndodhur pasi kuvendi komunal kishte aprovuar pozitat mirëpo nuk kishte buxhet në kategorinë e pagave në këtë drejtori.

Ndikimi Rekrutimi në mungesë të buxhetit për pozita të lira dhe mos përfshirja në listat e pagave duke mos paguar në mënyrë retroaktive të punësuarin mund të ndikoj në shpenzime shtesë përmes padive gjyqësore.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurohet që para fillimit të proceduarve të rekrutimit janë marrë aprovimet përkatëse për pozitat e lira dhe mjetet e buxhetuara. Njëherit të siguroj se stafi i angazhuar paguhet nga data e rekrutimit.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2019 ishte 1,433,329€, prej tyre ishin shpenzuar 1,374,137€. Ato kanë të bëjnë me furnizime me material shpenzues, shërbime, mirëmbajtje, shërbime komunale dhe shpenzime të tjera. Kemi testuar 39 mostra për teste substanciale në vlerë 200,748€ si dhe 8 mostra për teste të pajtueshmërisë.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 760,153€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 623,395€. Shpenzimet kryesisht kishin të bëjnë me bursa për studentë, mbështetje të entiteteve jo publike si dhe personave fizik si përfitues individual në gjendje të vështirë socio-ekonomike.

Në këto shpenzime, ne kemi testuar 14 mostra për teste substanciale në vlerë 52,961€ si dhe 17 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A4 - Mos respektim i rregullores për financimin e OJQ-ve.

Gjetja

Rregullorja MF Nr.04/2017 përcakton kriteret, standardet dhe procedurat themelore për financimin publik të organizatave jo-qeveritare (këtu e tutje OJQ), me qëllim të vendosjes së një sistemi transparent dhe llogaridhënës për financimin me fonde publike të programeve dhe projekteve të OJQ-ve që janë të interesit publik të në Republikën e Kosovës. Neni 6 dhe 26, përcaktojnë afatin kur ofruesi i mbështetjes financiare duhet të dërgoj në planin dhe raportin vjeor në zyrën e qeverisjes së mirë në Zyrën e Kryeministrit. Ndërsa neni 12, përcakton që çdo mbështetje financiare për OJQ-të duhet të shpallet me thirrje publike, e cila duhet të publikohet në ueb faqen e ofruesit të mbështetjes financiare.

Për vitin 2019, komuna nuk kishte përgatitur dhe nuk kishte dërguar në Zyrën e Kryeministrit, planin vjetor për mbështetjen financiare si dhe raportin vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të. Po ashtu, komuna kishte bërë financimin e OJQ-ve pa bërë shpalljen publike.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kujdesit jo të duhur të zyrtarëve përgjegjës që planin dhe raportin vjetor të dorëzojnë me kohë në Zyrë të Kryeministrit dhe financimi të bëhet përmes shpalljes publike.

Ndikimi

Mos dërgimi i planit dhe raportit vjetor me kohë në Zyrën e Kryeministrit, ndërsa financimi duke mos bërë shpallje apo thirrje publike për mbështetje financiare, pamundëson sigurimin e transparencës dhe qasjes së publikut në shpenzimin e mjeteve për financimin publik të OJQ-ve.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të siguroj që plani dhe raporti vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve dërgohen në zyrën përkatëse të qeverisë duke respektuar kriteret e afatet kohore të kërkuara si dhe financimi i OJQ të bëhet përmes shpalljes publike.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 6,824,715€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 4,597,263€. Ato kanë të bëjnë me investime në ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe objekteve të ndryshme kapitale si dhe bashkëfinancim me bujqit për furnizim me Sera, pajisje Bujqësore. Kemi testuar 91 mostra për teste substanciale në vlerë 3,044,030€ si dhe 9 mostra për teste të pajtueshmërisë. Lidhur me këto, ne kemi vërejtur si në vijim:

Çështja B3 – Mos vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit për vonesat në realizimin e punëve

Gjetja

Në kontratat e nënshkruara për projektet kapitale ishin përcaktuar afatet kohore për realizimin punëve. Ndërsa me rregullat dhe udhëzuesin operativ për prokurimin publik, pika 30.6 specifikohet se, siguria e ekzekutimit mbetet valide për një periudhë tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës.

Gjatë testimit ne kemi vërejtur se realizimi i projekteve kapitale kishte vonesa dhe përkundër kësaj komuna nuk kishte kërkuar vazhdimin e sigurisë së ekzekutimit për kontratat si në vijim:

- Kontrata “Ndërtimi i QMF-së në Fushë Kosovë” me vlerë 246,882€ e nënshkruar me datën 05.07.2019 do duhej të përfundonte 120 ditë sipas planit dinamik mirëpo punët ende nuk ishin përfunduar. Siguria e ekzekutimit kishte validitet deri më datën 01.12.2019, dhe si e tillë nuk ishte vazhduar deri me datën 15.06.2020 kur ne kemi audituar këtë kontratë; dhe
- Kontrata “Asfaltimi i rrugëve në Fushë Kosovë” me vlerë 175,958€ e nënshkruar me datën 22.05.2019, punët do duhej të përfundonin 60 ditë sipas planit dinamik mirëpo punët ende nuk ishin përfunduar. Siguria e ekzekutimit kishte validitet deri 19.08.2019. Edhe pse punët nuk kishin përfunduar siguria e ekzekutimit nuk ishte kërkuar që të vazhdohej.

Arsyeja e mos vazhimit apo vazhimit me vonesë ishte kontrolli dhe monitorimi jo i mirë i realizimit të kontratave dhe përcjelljes së validitetit të sigurisë së ekzekutimit.

Ndikimi

Kujdesi jo i duhur lidhur me vazhdimin e sigurisë së ekzekutimit në raste të dëmtimit të punimeve, komuna mund të përballet me shpenzime shtesë si dhe të mos arrij të marr kompensimin e dëmeve.

Rekomandimi B3

Kryetari, duhet të ndërmerr masat për forcimin e kontrolleve lidhur me mbikëqyrjen dhe zbatimin e projekteve sipas planit dinamik dhe kushteve të kontratës, në mënyrë që projektet të realizohen sipas planit dinamik. Njëherit për projekte që janë në vonesa të realizimit të sigurohet se është kërkuar vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit.

Çështja A5 - Mangësi në menaxhimin e kontratave**Gjetja**

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik si dhe Rregullat dhe udhëzuesi për prokurimin publik, përcaktojnë kriteret për menaxhimin e kontratës. “Menaxhimi i kontratës është përgjegjësi e menaxherit të projektit dhe i cili duhet të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë”.

Gjatë testimit të kontratave në kemi vërejtur që ishin pranuar dhe paguar punë apo furnizime të cilat nuk ishin sipas atyre të kontraktuara:

- Te kontrata “Ndërtimi i urës mbi lumin Drenica në fshatin Grabovc”, në vlerë prej 27,943€, nga ekzaminimi fizik i projektit ne kemi identifikuar se tri⁵ pozicione me vlerë 3,760€ nuk ishin realizuar ndonëse ishin faturuar dhe paguar sipas situacionit të fundit të punëve të përfunduara dhe pagesës së realizuar në vlerë 16,375€;
- Te kontrata “Blerja e dy mini autobusëve për të mbuluar nevojat e Administratës, Shëndetësisë dhe Arsimit”, tek pagesa në vlerë 65,000€ ne kemi identifikuar se komuna kishte pranuar mini autobusët jo në përputhje me specifikacionet e cekura në kontratë, ishin kërkuar mini autobusë me 4 dyer ndërsa ishin pranuar mini autobusë me 3 dyer.

Dobësitë e identifikuar kanë ndodhur si rezultat i kontrollit dhe monitorimit jo të mirë nga komisioni i pranimi dhe menaxherët e kontratave në pranimin dhe menaxhimin e drejtë të kontratave.

Ndikimi

Dobësitë me rastin e pranimi të punëve dhe furnizimeve jo në përputhje me kontratë nga komisionet e pranimi dhe menaxherët mund të rezultojë me pagesa të parregullta për punët të cilat nuk janë kryer apo furnizimet jo sipas kontratës.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të siguroj se komisionet e pranimi dhe menaxherët e kontratave aplikojnë kontrolle efektive me rastin e pranimi të punëve apo furnizimeve dhe se pagesat bëhen vetëm për punët/furnizimet e realizuara të cilat janë sipas kontratës.

⁵ 5.4-Furnizimi dhe vendosja e llamarinës së zinkuar me trashësi d=0.7mm dhe h=100mm, për largimin e kontrolluar të ujit nga trupi i urës në vlerë 1,800€;

6.1 Furnizimi dhe vendosja e shtresës ujë zbritës nën shtresën e asfaltit në vlerë 700€ dhe

6.2 Furnizimi dhe vendosja e asfaltit AB16 7cm në shtresën kaluese të urës në vlerë 1,260€.

Çështja A6 - Ndarje jo e duhur e detyrave**Gjetja**

Me Rregullën dhe Udhëzuesin operativ të prokurimit publik përcaktohet se një zyrtar nga një departament i cili ka përgatitur specifikimet dhe/ose termat e referencave, ose ka përcaktuar standardet e cilësisë, ose vizatimet e përgatitura nuk mund të marrë pjesë edhe si anëtar i komisionit të vlerësimit, si dhe një anëtar i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet si Menaxher i projektit

Lidhur me këtë, te kontrata “Furnizim me mekanizëm bujqësor – faza e dytë” në vlerë prej 57,400€, zyrtari që kishte përgatitur specifikimet përkatësisht para masën dhe parallogarinë e projektit, njëherit ishte caktuar anëtar i komisionit të vlerësimit.

Shkaku i ndodhjes së kësaj, sipas zyrtarëve përgjegjës ishte bërë për shkak të mungesës së stafit.

Ndikimi

Ndarja jo e duhur e detyrave përgjatë procesit të prokurimit mund të ndikoj në favorizime të mundshme për ndonjë operatori ekonomik të caktuar si dhe në trajtimin jo të barabartë të ofertuesve me rastin e procesit të vlerësimit.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të siguroj se do të ketë ndarje të duhur të detyrave të punës gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, në mënyrë që zyrtarët që i kanë përgatitur termat e referencës/specifikimet teknike të mos të marrin pjesë në vlerësimin e ofertave duke shmangur çfarëdo konflikti të mundshëm.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 52,293,411€, pasurive jokapitale është 731,519€, si dhe e stokeve 78,670€. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 3,057,688€, si dhe 6 mostra për teste të pajtueshmërisë.

2.3 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2019 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 3,705,777€. Prej tyre 2,588,036€ janë nga të hyrat e tatimit në pronë, 782,408€ nga taksat e bizneseve në veprimtari, 177,343 nga lejet e ndërtimit, 16,279 nga shitja e pasurisë si dhe të hyrat nga dhënia në shfrytëzim e pronës dhe objekteve publike komunale prej 141,711€.

Ne kemi testuat 87 mostra për teste substanciale në vlerë 366,728€, si dhe 12 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B4 – Sfidat në menaxhimin e të arkëtueshmeve

Gjetja Sipas Ligjit Nr 06/L – 005 për tatimin në pronën e paluajtshme, nenin 26 Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Përkundër përpjekjeve që kishte bërë komuna përmes vërejtjeve individuale dhe marrëveshjeve me disa tatimpagues për pagesën e borxhit tatimor me këste, vlerat e llogarive të arkëtueshme të tatimit në pronë në fund të vitit ishte 2,588,036€ me një rritje prej 207,926€ në raport me vitin e kaluar. Pjesa më e madhe e tyre janë të arkëtueshme të vjetra nga vitet paraprake.

Sipas komunës gjendja ekonomike e sociale e komunës, ka sjell deri te mos pagesa e borxheve tek tatimi në pronë.

Ndikimi Mos arkëtimi i të arkëtueshmeve rrezikon që ato vjetërsohen dhe të bëhen të pa arkëtueshme, duke krijuar një humbje të drejtpërdrejtë financiare për Komunën. Kjo redukton edhe fleksibilitetin e komunës ndaj shpenzimeve të planifikuara që financohen nga të hyrat vetjake.

Rekomandimi B4 Kryetari, duhet të analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e borxheve, si dhe të propozoj masa dhe procedura plotësuese për të reduktuar sa më shumë gjendjen e këtyre llogarive.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 147,996€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Ne kemi testuar 5 mostra për teste substanciale për detyrimet e papaguara në vlerë 24,784€ dhe 12 mostra për teste të pajtueshmërisë.

2.4.2 Detyrimet e kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 973,975€. Ne kemi testuar 24 mostra me vlerë prej 926,164€ që kishin të bënin me çështje të ndryshme si: kompensime dëmi, kompensim për mos përmbushje të kontratës nga ana e komunës, kompensim për largim nga puna, kompensim për shpronësim prone, kompensim për mos kryerjen e pagave shtesë etj.

2.4.3 Detyrimet e kontraktuale

Pasqyra e detyrimeve kontraktuale në fund të vitit 2019, ishte 934,189€, detyrimet që kishin të bënin me projektet kapitale dy/tre vjeçare, si dhe disa projekteve të cilat ishin në vonesë në kryerjen e punimeve dhe ishin bartur për realizim në vitin pasues .

2.5 Funksioni i auditimit të brendshëm

Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy auditor. Përveç Planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe Planin vjetor të punës ku ishin paraparë të kryhen gjashtë auditime që i përkisnin fushave me rrezik të lartë dhe të mesëm. Po ashtu, kishte përgatitur raportin gjashtë mujor dhe vjetorë, të cilin e kishte dërguar në Njësinë Qendrore Harmonizuese.

Komiteti i Auditimit përbëhet prej tre anëtarëve dhe gjatë vitit 2019, kishte mbajtur dy takime për të shqyrtuar raportet e NjAB-së. Lidhur me funksionimin e auditimit të brendshëm ne kemi trajtuar si në vijim:

Çështja B5 – Sfidat në përmbushjen e planit vjetor të auditimit**Gjetja**

Sipas planit vjetor të Auditimit të Brendshëm, NJAB kishte planifikuar të kryej gjashtë auditime për vitin 2019.

Nga gjashtë auditimet e planifikuara gjatë vitit kishte arritur t'i përfundoj vetëm dy prej tyre dhe një auditim me kërkesë nga menaxhmenti. Për më tepër AB nuk kishte mbuluar fushat me rrezik të lartë: si të hyrat vetjake, shpenzimet përmes prokurimit, subvencionet etj.

Kjo ka ndodhur si shkak të auditimit me kërkesë nga menaxhmenti dhe detyrave shtesë në përcjelljen e implementimit të rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Ndikimi

Niveli i dobët i realizimit të planit të auditimit nga NJAB, zvogëlon sigurinë në lidhje me funksionimin e sistemeve financiare. Mungesa e aktiviteteve efektive të auditimit të brendshëm mund të ndikojë në vazhdimin e përsëritjes së dobësive në sistemet kyçe të kontrollit të brendshëm dhe menaxhmenti të mos jetë në gjendje të reagoj me kohë për eliminimin e tyre.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë se sistemi i auditimit të brendshëm, vepron në mënyrë efektive, në mënyrë që t'i shtoj vlerë përmirësimit të aktiviteteve operative dhe cilësisë së kontrolleve të brendshme aktuale, e njëkohësisht të përmbushen edhe objektivat e planifikuara në planin vjetor të punës.

Çështja A7 - Mos funksionimi efektiv i Komitetit të Auditimit

- Gjetja** Sipas Udhëzuesit MF -Nr.01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit, nenet 6, 8, 10 përcaktojnë që Komiteti i Auditimit duhet të përgatit statutin, takimet e Komitetit të Auditimit mbahen së paku katër herë në vit dhe duhet të përgatit raportin vjetor për udhëheqësin e sektorit publik.
- Gjatë auditimit ne kemi vërejtur që KA nuk kishte përgatitur statutin, kishte mbajtur vetëm dy takime prej katër sa kërkoheshin. Po ashtu, KA nuk kishte përgatitur as raportin vjetor i cili duhet të përfshijë informatat për: përshtatshmërinë e mjedisit të kontrollit të brendshëm, sistemit të menaxhimit të rrezikut dhe mënyrat e eliminimit të tyre, përshtatshmërinë e menaxhimit të sistemi financiar dhe raportimin etj.
- Arsyeja e mos përmbushjes së kërkesave të udhëzimit ishte mos funksionimi efikas i Komitetit të Auditimit.
- Ndikimi** Mos respektimi i udhëzuesit si dhe mos funksionimi efektiv i KA-së, mund të ndikoj në pamundësinë e ofrimit të sigurisë për menaxhmentin e komunës në përmirësimin e kontroleve të brendshme, qeverisjen e mirë dhe menaxhimin e rrezikut në komunë.
- Rekomandimi A7** Kryetari duhet të sigurojë se Komiteti i Auditimit, funksionon në mënyrë efektive, jep kontributin e vet në qeverisjen e mirë, kontrollet e brendshme dhe menaxhimin e rrezikut, si dhe ka një bashkëpunim të ngushtë me NJAB-në.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të Komunës së Fushë Kosovës ka rezultuar në 14 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

Sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit respektivisht neni neni 14 pika 5 e rregullores përcakton se OB janë të obliguar që dy herë në vit respektivisht 30 shtator dhe 15 mars të përgatitin raporte lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve. Komuna e Fushë Kosovës për vitin 2019 ka dërguar vetëm raportin e parë, ndërsa të dytin ende nuk e ka dërguar. Edhe pse menaxhmenti kishte dhënë komentet se rekomandimet janë adresuar apo janë në proces, ne kemi identifikuar që 5 rekomandime nuk ishin zbatuar.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, prej 14 rekomandimeve, shtatë (7) rekomandime janë zbatuar, pesë (5) rekomandime nuk ishin zbatuar ende dhe dy (2) rekomandime janë konsideruar të mbyllur. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryetari duhet të konsideroj bashkëpunim të ndërsjellë me Ministrinë e Financave, për ndarjet buxhetore për kategori ekonomike, në mënyrë që të sigurojë një planifikim të mirëfilltë, të drejtë dhe të sakët të buxhetit për projektet dhe kategoritë specifike, në mënyrë që të eliminohen gabimet në klasifikimin e shpenzimeve, nëpër kategori përkatëse ekonomike, të cilat do të reflektohen drejt edhe në paraqitjen e PFV-ve.	Edhe në këtë vit kemi keq klasifikime, shih çështjen B1.	I përsëritur.
2	Realizimi buxhetit	Kryetari, duhet të sigurojë që gjatë përgatitjes së kërkesave buxhetore t'i paraprijë një analizë e mirëfilltë e të gjithë faktorëve, që kanë ndikim në realizimin e buxhetit. Ndërsa, planifikimi dhe buxhetimi i projekteve të caktuara duhet të bëhet bazuar në planin kontabël të aprovuar nga Thesari.	Menaxhmenti kishte ndërmarr masa për ekzekutimin e buxhetit të kapitale. Kjo çështje nuk do të trajtohet në raportin e auditimit të vitit 2019.	I mbyllur.
3	Të hyrat	Kryetari, duhet të siguroj se të gjithë qiramarrësit kanë kontrata për shfrytëzimin e pronave publike, në mënyrë që të kenë bazë ligjore për arkëtimin e të hyrave nga qiradhënia e tyre.	menaxhmenti kishte ndërmarr masa për nënshkrimin e kontratave për qiramarrësit.	I zbatuar.
4		Kryetari, duhet të sigurojë se asnjë pronë publike nuk do të lejohet të shfrytëzohet dhe keqpërdoret pa pagesën e qirave të parapara me kontratë. Duhet të gjenden forma, që të merren masa të menjëhershme (një mundësi e tillë përmes përmbaruesit) që detyrojnë obliguesit të respektojnë detyrimet kontraktuale.	Edhe këtë vit janë identifikuar dobësitë e njëjta.	I përsëritur.

5	Mallra dhe Shërbime	Kryetari, duhet të sigurojë një plan të arsyeshëm për punët që ndërliken me shërbimet me marrëveshje të veçanta. Po ashtu, nevojat shitesë për punëtorë me pozita të rregullta, t'i trajtoj me organet përkatëse dhe të gjendet zgjidhja e pranuar, të parashikohen me rastin e planifikimeve buxhetore.	MSHV gjatë tremujorit të parë të vitit ishin paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa në muajt pasues ishin paguar përmes projektit "Ofrimi i shërbimeve sociale, arsimore dhe tjera" nga Caritas.	I zbatuar.
6		Kryetari, duhet të bëjë një rishikim të brendshëm të kontrolleve, për të përcaktuar vendimet lidhur me formimin e komisionit përkatës për të konfirmuar se furnizimet janë pranuar sipas cilësisë dhe sasisë së paraparë me kontratë.	Ne nuk kemi identifikuar çështje të tillë vitin 2019.	I zbatuar.
7	Investime Kapitale	Kryetari, duhet të ndërmerr masat për forcimin e kontrolleve lidhur me mbikëqyrjen, e zbatimit të projekteve sipas planit dinamik dhe kushteve të kontratës, si dhe zgjidhjen e çështjeve pronësore dhe administrative (marrjen e lejeve përkatëse), para fillimit të punimeve, në mënyrë që mos të ketë ndërprerje të punimeve dhe projektet të realizohen sipas planit dinamik.	Edhe këtë vit, ne kemi vërejtur që komuna kishte vonesa në implementim të planit dinamik dhe nuk kishte vazhduar sigurinë e ekzekutimit.	I përsëritur.
8		Kryetari, duhet të sigurojë se me rastin e bashkëfinancimeve, do të jenë palë aktive dhe e barabartë në përcjelljen, realizimin dhe mbikëqyrjen e këtyre projekteve. Po ashtu duhet siguruar se projektet në të ardhmen të realizohen në bazë të objektivave të parapara të programit.	Komuna kishte zhvilluar procedura të prokurimit dhe kishte menaxhuar projektin në përputhje me objektivat e përcaktuara.	I zbatuar.
9	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që komisioni të hartojë raportin gjithëpërfshirës në mënyrë që regjistri i pasurisë të jetë i plotë dhe i saktë.	Nuk kemi identifikuar këtë vit mangësi në raportin e komisionit për inventarizimin e pasurisë.	I zbatuar.

10		Kryetari, duhet të sigurojë janë marrë veprime të nevojshme për regjistrimin e plotë të pasurisë në SIMFK dhe sistemin e-pasuria, në mënyrë që të ketë një menaxhimin dhe raportim të pasurisë në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.	Nuk kemi identifikuar këtë vit mangësi në raportin e komisionit për inventarizimin e pasurisë.	I zbatuar.
11	Të arkëtueshmet	Kryetari, duhet të analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e borxheve, si dhe të propozoj masa dhe procedura plotësuese për të reduktuar sa më shumë gjendjen e këtyre llogarive.	Edhe këtë vit kemi të njëjtën çështje.	I përsëritur.
12	Obligimet e papaguara	Kryetari, duhet të konsideroj që me rastin e planifikimit të buxhetit, t'i trajtoj obligimet e mbetura me MF dhe të vendosë prioritetet buxhetore, në kryerjen e obligimeve. Me tutje të caktoj politika konkrete për t'i kryer obligimet me kohë, sipas afatit të paraparë ligjor, në mënyrë që të parandalojë hyrjen në obligime të reja.	Ne nuk kemi identifikuar çështje të tillë vitin 2019.	I zbatuar.
13	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë se sistemi i auditimit të brendshëm, vepron në mënyrë efektive, në mënyrë që t'i shtoj vlerë përmirësimit të aktiviteteve operative dhe cilësisë së kontrolleve të brendshme aktuale, e njëkohësisht të përmbushen edhe objektivat e planifikuara në planin vjetor të punës.	Edhe këtë vit janë identifikuar dobësitë e njëjta.	I përsëritur.

14	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari, duhet të sigurojë se është kryer një rishikim, për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartojë regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrolle kërcënimet e ekspozuara.	Kjo çështje nuk do të trajtohet në raportin e auditimit të vitit 2019.	I mbyllur.
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo ridestinin të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.		
2	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave komunale do të bëhet ashtu siç parashihet me ligj duke bërë verifikimin e pronave së paku 20 % në vit, për të reflektuar në gjendjen reale të pronave të tatuara.		
3		Kryetari duhet të inicioj aprovimin e pozitave të reja në drejtorit që kanë mungesë të stafit dhe të siguroj që shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve si dhe njoftimi i tyre bëhet brenda afateve ligjore.		
4		Kryetari, duhet të sigurojë se asnjë pronë publike nuk do të lejohet të shfrytëzohet pa pagesën e qirave të parapara me kontratë. Duhet të gjenden forma, që të merren masa të menjëhershme (një mundësi e tillë përmes përmbaruesit) që detyrojnë obliguesit të respektojnë detyrimet kontraktuale.		
5	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurohet që para fillimit të proceduarve të rekrutimit janë marrë aprovimet përkatëse për pozitat e lira dhe mjetet e buxhetuara. Njëherit të siguroj se stafi i angazhuar paguhet nga data e rekrutimit.		
6	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj që plani dhe raporti vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve dërgohen në zyrën përkatëse të qeverisë duke respektuar kriteret e afatet kohore të kërkuara si dhe financimi i OJQ të bëhet përmes shpalljes publike.		
7	Investimet kapitale	Kryetari, duhet të ndërmerr masat për forcimin e kontrolleve lidhur me mbikëqyrjen dhe zbatimin e projekteve sipas planit dinamik dhe kushteve		

		të kontratës, në mënyrë që projektet të realizohen sipas planit dinamik. Njëherit për projekte që janë në vonesa të realizimit të sigurohet se është kërkuar vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit.
8		Kryetari duhet të siguroj se komisionet e pranimi dhe menaxherët e kontratave aplikojnë kontrole efektive me rastin e pranimi të punëve apo furnizimeve dhe se pagesat bëhen vetëm për punët/furnizimet e realizuara të cilat janë sipas kontratës.
9		Kryetari duhet të siguroj se do të ketë ndarje të duhur të detyrave të punës gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, në mënyrë që zyrtarët që i kanë përgatitur termit e referencës/specifikimet teknike të mos të marrin pjesë në vlerësimin e ofertave duke shmangur çfarëdo konflikti të mundshëm.
10	Të arkëtueshmet	Kryetari, duhet të analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e borxheve, si dhe të propozoj masa dhe procedura plotësuese për të reduktuar sa më shumë gjendjen e këtyre llogarive.
11	Funksioni i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë se sistemi i auditimit të brendshëm, vepron në mënyrë efektive, në mënyrë që t'i shtoj vlerë përmirësimit të aktiviteteve operative dhe cilësisë së kontrolleve të brendshme aktuale, e njëkohësisht të përmbushen edhe objektivat e planifikuara në planin vjetor të punës.
12		Kryetari duhet të sigurojë se Komiteti i Auditimit, funksionon në mënyrë efektive, jep kontributin e vet në qeverisjen e mirë, kontrollet e brendshme dhe menaxhimin e rrezikut, si dhe ka një bashkëpunim të ngushtë me NJAB-në.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër e Konfirmimit



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA
KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË
OPSTINA KOSOVO POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË KOSOVË , KOSOVO POLJE

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit
për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Fushë Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

z. Burim Berisha

Kryetar i Komunës së Fushë Kosovës

Data: 10 korrik 2020, Fushë Kosovë

